

FRUTIKULTURE: Fishe teknike

Rrallimi i frutave

N° 03

Adad Malore:

Tel: 0682066485,
info@adadmalore.al
www.adadmalore.al

Dr. Hafuz DOMI

domihafuz@yahoo.com

RRALLIMI I FRUTAVE TË MOLLËS

Rallimi i frutave të mollë është një nga proceset më të rëndësishme që ka të bëjë me;

- Çlirimin e pemës nga ngarkesa e tepërt
- Harmonizimin masen vegetative dhe frutifikimin
- Normalizimin e prodhimit
- Siguron prodhim të përvitëshëm
- Rritjen e cilësisë e prodhimit
- Rendimentin e pritëshëm të prodhimit

Menyrat e rrallimit janë me dorë dhe ai kimik ;

- Me dorë aplikohet në pemëtore ekstensive dhe me sipërfaqe të vogla
- Kimik përdoret në sipërfaqe të mëdha dhe në mungesë të fuqisë punëtore

Koha e rrallimit :

- Të rrallohen frutat që në momenti kur kur mollët kanë arritur madhësinë sa një kokërr kumbulle, që përkon rrëzimit të Qershorit.

Këshilla për rrallimin me dorë i frutave të mollës

1. Rrallimi lejon të kemi fruta me të mëdha dhe me të mira në cilësi. Nuk duhet të lihen shumë fruta në një pemë, por nuk duhet të heqim më shumë në asnjë mënyrë.
2. Lulet janë të vendosura në buqëta. Çdo lule mund të japë një frut dhe ato mund të jenë të shumta.
3. Për pemët që kanë % lulëzimi normal (afërsisht 50% të lulëzimit në raport me sythet e degëzave) nuk duhet të mbahet më shumë se një frut për buqet, preferohet fruti qëndror, që është më i madh, hiqen të gjitha frutat me njolla ose të prekura, të vogla, të thata apo të kalbura.
4. Pra duhet të hiqen frutat e tepërta që të mos rëndojnë në pemë në mënyrë që të mos dëmtojnë frutat e tjera.
5. Gjatë rrallimit kokrrat këputen duke i lënë bishtin në degëz dhe duhet shmangur dëmtimi i degëzave.
6. Numri i frutave që duhet të lihet në një pemë, varet nga mosha e pemës dhe kurora e saj, nga fuqia e rritjes dhe numri i buqetave të luleve në pemë:
 - a. Në një pemë të re (me pak se 8 vjeçare) me një fuqi rritje të mirë nuk duhen të mbahen më shumë se 400 fruta/pemë.
 - b. Në pemë akoma më të reja (afërsisht 5 vjeçare) nuk duhet të mbahen më shumë se 150-200 fruta/pemë.
 - c. Në plantacione të reja nuk duhet të mbahen më shumë se 40 fruta maksimumi për të siguruar një të ardhme të mirë për vitin e ardhshëm